



Primitje / Dërgim Prilazje / Protokolo Received / Delivery	12.07.2022	2	viti god year
Organ / Shërbimi Organ / Jedinstvo Org / Unit	SKPMSSHCK	4040/2022	Sasia Kolicina Quantity
			116



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.456/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita haxnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.456/2022 të datës 16.05.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

kundër Vendimit me numër KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.456/2022 e datës 16.05.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KD.Nr.020-/2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës i datës 15.04.2022.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, përmes e-mailit [ankesa.kpmschck@rks.gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks.gov.net), më datë 16.05.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.456/2022 me numër protokolli 2844/2022, kundër Vendimit me numër KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me pretendimet që masa disiplinore nuk është e shqiptuar në proporcion me shkeljen e supozuar.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.05.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 31.05.2022 ka pranuar nga Shërbimi Korrektues të Kosovës përgjigjen në kërkesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit me datë 29.06.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër VK.nr.63/2022 me qëllim të shtyrjes së afatit për vendosje edhe për dhjetë (10) ditë pune sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit të datës 24.06.2022 për shkak të nevojës të shqyrtimeve shtesë për shkak të specifikave të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 2844/2022 të datës 16.05.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Emailin e datës 16.05.2022 të ankuesit; Shkresën e datës 04.12.2017 me përshkrimin e detyrave të punës për pozitën: Zyrtar për trajtimin e të burgosurve dhe çështje sociale; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.05.2022; E-mailin e datës 30.05.2022 dërguar nga SHKK me përgjigjen në kërkesë të datës 30.05.2022; Akt emërimit e ankuesit të datës 04.12.2017; Shkresën me detyrat e punës për pozitën që e mban ankuesi, Inicimi i procedurës disiplinore të datës 16.03.2022; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore të datës 10.03.2022; Vendimin për formimin e komisionit profesional i datës 08.10.2019; Raportin përfundimtar të hetimeve i datës 07.02.2022 me numër 0115; Vendimin për formimin e komisionit të brendshëm hetimor; kërkesën për ekzekutimin e dënimit me burgim i datës 19.05.2021; Aktgjykimin PS54/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special; Aktgjykimin APS.nr.1/21 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti Special; Shkresa me përlllogaritjen e dënimit e datës 11.11.2021; Formularin e vlerësimit për beneficione Ref. 4.4 i datës 16.03.2021; Kërkesën me Nr. Protokol: 901 e datës 12.03.2021; Forma e panelit për beneficione Ref.4.4.1 e datës 16.03.2021; Formularin e vlerësimit për beneficione Ref.4.4 e datës 19.03.2022; Raporti për pushim jashtë burgut i datës 22.03.2021 dhe 19.03.2021; Kërkesë me Nr.Protokol:941 e datës 17.03.2021; Certifikatë e martesës e datës 16.03.2021; Forma e panelit për beneficione Ref.4.4.1 e datës 22.03.2021; Shkresën për rivlerësim për beneficione Ref. 4.1.5 e datës 30.04.2021; Kërkesën me Nr. Protokol: 1470 e datës 29.04.2021; Forma e Panelit për Beneficione Forma 4.1.4/1 e datës 11.05.2021; Shkresë për rivlerësim për beneficione Ref.4.1.5 e datës 28.06.2021; Kërkesë me Nr.Protokol:2142 e datës 21.06.2021; Formular i Panelit për beneficione Forma.4.1.4/1 e datës 29.06.2021; Shkresë për rivlerësim për beneficione Ref.4.1.5 e datës 28.09.2021; Kërkesë e datës 28.09.2021; Formular i Panelit për beneficione Forma.4.1.4/1 e datës 28.09.2021; Çertifikatën e martesës nën shenjë 19/2005RM të datës 16.03.2021; Vendimi i datës 27.10.2020 i nxjerr nga Drejtori i BSL-së; Njoftim i datës 23.03.2021, 25.05.2021, 21.07.2021, 28.09.2021; Shkresë e datës 24.03.2021, 25.05.2021 dhe 21.07.2021.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e **pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka gjetur që ankuesi në bazë të aktit të emërimit të datës 14.12.2017 është i punësuar në pozitën Zyrtar për Trajtimin e të Burgosurve dhe Çështjeve Sociale në Burgun e Sigurisë së Lartë në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa bazuar në Raportin Përfundimtar të Hetimeve me Nr.0115 të datës 07.02.2022 të Komisionit Hetimor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në bazë të të cilit është gjetur që janë bërë shkelje lidhur me realizimin e vizitës së lirë nga i burgosur F.M në Burgun e Sigurisë së Lartë, më datë 10.03.2022 ndaj ankuesit është iniciuar procedurë disiplinore në Komisionin Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 15.04.2022 ka nxjerr Vendim KD.Nr.020-/2022, me të cilin ka bërë përgjegjës ankuesin për shkelje të rënda disiplinore për shkak që në katër raste aprovon beneficione/vizitë e lirë (qëndrim në lokalet e veçanta me bashkëshortes) për të dënuarin F.M, duke u shqiptuar masën disiplinore "Ndalim 20% i pagës për periudhë një muaj".

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, me pretendimet që masa disiplinore nuk është e shqiptuar në proporcion me shkeljen e supozuar.

Lidhur me përgjegjësin disiplinore, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, i'u referua nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".* Ndërlidhur me këtë në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, janë kualifikuar shkeljet e rënda të detyrave të punës: *"Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë".*

Bazuar në provat e lëndës, konkretisht në Raportin Përfundimtar të Hetimeve me Nr.0115 të datës 07.02.2022 të Komisionit Hetimor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka gjetur se nga Komisioni Profesional i cili do të merret



me shqyrtimin e rasteve të shqyrtimit të kërkesave për beneficione në kuadër të institucionit korrektues i themeluar me Vendimin me Nr. 747 të datës 08.10.2019 në të cilin ankuesi është anëtar i këtij komisioni janë aprovuar raste të beneficionit respektivisht vizitës së lirë në lokale të veçanta me bashkëshorten për të burgosurin F.M, pa u plotësuar kushtet ligjore për të shfrytëzuar këtë të drejtë që janë në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 pika 1.1, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2012 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, duke rekomanduar që të merren masa ndaj anëtarëve të komisionit profesional-panelit.

Nga shqyrtimi i provave materiale të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka gjetur se komisioni profesional në këtë rast edhe ankuesi si anëtar i këtij komisioni, ka bërë aprovimin e katër kërkesave gjegjësisht: *Kërkesa me Nr:Protkol:941 e datës 16.03.2021 i burgosur F.M për lejimin e vizitës së lirë më datë 24.03.2021, e cila nga paneli është aprovuar më datë 22.03.2021; Kërkesa me Nr:Protkol:1470 e datës 29.04.2021 i burgosur F.M për lejimin e vizitës së lirë më datë 19.05.2021, e cila nga paneli më datë 07.05.2021 është aprovuar; Kërkesa me Nr:Protkol:2142 e datës 18.06.2021 i burgosur F.M për lejimin e vizitës së lirë më datë 07.07.2021, e cila nga paneli më datë 29.06.2021 është aprovuar; Kërkesa e datës 28.09.2021 i burgosur F.M për lejimin e vizitës së lirë më datë 29.09.2021, e cila nga paneli më datë 28.09.2021 është aprovuar.* Ndërsa në bazë të kërkesë së datës 18.06.2021 me Nr:Protkol:2142 i burgosuri F.M, ka potencuar që *"...pas që më është premtuar nga po ashtu edhe nga që unë do ta kem vizitën e lirë çdo muaj e gjysmë"*.

Udhëzimi Administrativ MD-Nr.07/20151 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, konkretisht neni 48, përcakton se: *"Për realizimin e së drejtës në benificion për kalimin e kohës në lokale të veçanta duhet të plotësohen këto kushte: 1.1.sjellja e mirë e personit të dënuar gjatë mbajtjes së dënimit; 1.2.të mos jetë shfrytëzues i pushimit jashtë institucionit korrektues. 2. E drejta në benificion për kalimin e kohës në lokale të veçanta mund t'i lejohet personit të dënuar me të paktën dy (2) vjet dënim me burgim që mund të shfrytëzohet vetëm pasi të kenë kaluar gjashtë (6) muajt e parë të dënimit"*, ndërsa bazuar në provat e lëndës, Kolegji ka gjetur se i burgosuri F.M, me Aktgjykimin P S 54/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, edhe shpallur fajtor dhe është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e gjashtë (6) muaj, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti Special, me datë 10.02.2021 përmes Aktgjykimit APS.nr. 1/2, ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të akuzuarit F.M duke vërtetuar Aktgjykimin P S 54/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, rrjedhimisht Ushtruesi i detyrës i Kryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë më datë 19.05.2021 tek Burgu i Sigurisë së Lartë ka bërë kërkesën për ekzekutimin e dënimit me burg, ndaj të burgosurit F.M.

Bazuar në këtë rrethana si dhe deklaratimet e ankuesit në seancë të Komisionit Disiplinor, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për aprovimin e kërkesave të burgosurit F.M për vizatë të lirë, rrjedhimisht ankuesi me veprimet e tij, ka vepruar në kundërshtim me nenin me nenin 25 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *"2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës.3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforsimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike"*, sepse zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij, siç parashihet me nenin 28 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se ankuesi me rastin e mos përmbushjes së detyrave të punës është përgjegjës për shkeljen e kryer të përcaktuara si në nenin 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *“Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore; Shkelje të rënda konsiderohen: 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi;”*, kështu që komisioni disiplinor lidhur me këtë çështje juridike ka marr për bazë dispozitat e nenit 50 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *“Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dënimit. 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 3. Për shkeljet e rënda, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji. 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore”*. Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues i Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022, ka vepruar në pajtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, siç përcaktohet se: *“1. Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”,* ndërlidhur me nenin 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor”,* nga rrjedh se Komisioni Disiplinor ka vepruar në pajtim me nenin 50 paragrafin 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 13 paragrafin 3, 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankuesit që masa disiplinore nuk është e shqiptuar në proporcion me shkeljen e supozuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, po ashtu thekson faktin se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.Nr.020-/2022 të datës 15.04.2022, ka trajtuar çështjen disiplinore për pesë (5) zyrtarë, ndërsa refuzimi i ankesës së ankuesit të datës 16.05.2022 dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit Disiplinor ka të bëjë vetëm me pikën IV të dispozitivit ku përcaktohet në mënyrë taksative masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër **A.nr.456/2022**

**Elakron GASHI**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

